

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar  
Financial Reporting

**P5**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 13.01.2018

## CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</b>
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	15	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
<b>Totali</b>	<b>100</b>	

## Problemi 1

Melisa sh.a (Melisa) bleu 80% të kapitalit aksionar të emetuar të Margarita sh.a (Margarita) me 1 prill 2016, dhe 30% të kapitalit aksionar të emetuar të Mimoza sh.a (Mimoza) me 30 shtator 2016. Çmimi i tregut të aksioneve të Melisë me 1 prill 2016 dhe me 30 shtator 2016 ishte €3.00.

Melisa pagoi për blerjen e aksioneve në Margarita duke emetuar:

- 3 aksione të ekuitetit të saj oër çdo 5 aksione të blera në Margarita; plus
- Nota krediti me €100 (vlerë nominale) me 6% për çdo 250 aksione të blera në Margarita. Notat e kreditit ripaguhen në vlerën nominale me 31 mars 2018.

Çmimi i tregut të aksioneve të ekuitetit të Margarita ishte €2.10 për aksion me 1 prill 2016.

Melisa pagoi për blerjen e aksioneve në Mimoza duke emetuar 2 aksione për çdo 3 aksione në Mimoza. Çmimi i tregut të aksioneve të Mimoza në datën e blerjes ishte €2.60.

Draft pasqyrat e përmbledhura të pozites financiare të të tri kompanive me 31 mars 2017 janë si në vijim:

	<b>Melisa</b>	<b>Margarita</b>	<b>Mimoza</b>
	<b>€ m</b>	<b>€ m</b>	<b>€ m</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>			
Pronat, fabrikat dhe paisjet	2,228	810	400
Investimet në Margarita	160	-	-
Investimet tjera	<u>350</u>	<u>40</u>	<u>-</u>
	2,738	850	400
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>			
Stoqet	160	84	80
Të arkëtueshmet tregtare	320	147	90
Banka	<u>62</u>	<u>40</u>	<u>30</u>
	<u>542</u>	<u>271</u>	<u>200</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>3,280</b>	<b>1,121</b>	<b>600</b>
<i>Ekuiteti:</i>			
Aksionet e kapitalit të zakonshëm 50 cent secila	1,040	250	120
Fitimet e mbajtura: Saldo me 1 prill 2016	720	610	310
Viti deri me 31 mars 2017	<u>210</u>	<u>160</u>	<u>90</u>
	1,970	1,020	520
<i>Detyrimet afatgjata:</i>			
8% Obligacione	850		
6% Nota krediti	<u>160</u>		
	1,010		
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>			
Të pagueshmet tregtare	<u>300</u>	<u>101</u>	<u>80</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>3,280</b>	<b>1,121</b>	<b>600</b>

### **Informata shtesë:**

- i) Melisa deri me tani ka regjistruar vetëm emetimin e notave kreditit 6% sa i përket blerjes së aksioneve në Margarita. Aksionet e emetuara nuk janë regjistruara ende.
- ii) Në datën e blerjes, vlerat e drejta të pasurive të Margaritës ishin të barabarta me vlerat e tyre bartëse me perjashtim të dy pasurive: (1) disa toka kishin një vlerë të drejtë prej €20m më të ulët se vlerat e tyre bartëse. Kjo nuk është reflektuar në pasqyrat financiare të dhëna më sipër; (2) stoqet e Margarita kishin vlerë të drejtë prej €12m mbi vlerën e tyre bartëse. Stoqet ishin shitur deri me 31 mars 2017.
- iii) Me 30 shtator 2016, Melisa shiti një fabrikë tek Margarita sipas vlerës së drejtë prej €60m, që ishte €20m më shumë se vlera bartëse e saj. Jeta e vlerësuar e mbetur e kësaj pasurie ishte 4 vite nga ajo datë, dhe fabrika zhvlerësohet në baza drejtvizore.
- iv) Gjatë vitit, Margarita shiti mallra tek Melisa për €54m, me një marzhë mbi kosto prej 50%. Dy të tretat e këtyre mallrave u shiten nga Melisa tek palët e treat deri me 31 mars 2017.
- v) Melisa ka €2m të pagueshme tregtare ndaj Margarita në fund të vitit.
- vi) Obligacionet 8% janë emetuar nga Melisa me 1 prill 2016 me vlerë nominale prej €850m. Megjithatë, janë të pagueshme me nje premi prej 20%. Efekti i premisë është që të rritet kosto efektive e financimit në 10%. Kuponi i interesit prej 8% është paguar dhe kontabilizuar deri me këtë datë; megjithatë, nuk janë bërë korigjime në kontabilitet për të reflektuar shpengimin (rritjen e vlerës për shkak të premisë).
- vii) Melisa ka adoptuar një politike të vlerësimit të interesit jo-kontrollues (IJK) sipas vlerës së drejtë në datën e blerjes. Për qëllim të vlerësimit të vlerës së drejtë të IJK-së në Margarita, çmimi i aksioneve të Margarita duhet të përdoret.
- viii) Zëri i mirë i konsoliduar është rishikuar për dëmtim me 31 mars 2017 dhe një dëmtim prej €30m është konsideruar i domosdoshëm. Investimet në Mimoza janë rishikuar për dëmtim në po të njejtën datë dhe është konsideruar që nuk ka dëmtim.

### **Kërkohet:**

**Përgadite, në pajtim më SNRF-të, pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të Melisa sh.a me 31 mars 2017** **(25 pikë)**

## Zgjidhja e Problemit 1

1.

Struktura e grupit:

Melisa 80% pronësi në Margarita për tërë vitin – Degë/Filial

Melisa 30% pronësi në Mimoza për gjysëm viti – Shoqëri

### **Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare të grupit Melisa sh.a me 31 mars 2017**

	<b>€m</b>
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	
Pronat, fabrikat dhe paisjet (2,228 +810 -20 (L16 (ii)) -17.5 (L16(iii)))	3,000.5
Zëri i mirë (L12)	208
Shoqëria (L13)	157.5
Investimet tjera (350 + 40)	<u>390</u>
	3,756
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>	
Stoqet (160 + 84 - 6 (L16(iv)))	238
Të arkëtueshmet tregtare (320 +147 - 2 (L16(v)))	465
Banka (62 + 40)	<u>102</u>
	<u>805</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>4,561</b>
<i>Ekuiteti:</i>	
Kapitali aksionar (1,040 + 120 (L11) + 24 (L11))	1,184
Premia e aksioneve (600 (L11) +120 (L11))	720
Fitimet e mbajtura (L14)	<u>998.6</u>
	2,902.6
Interesi jo-kontrollues (L15)	<u>232.4</u>
	3,135
<i>Detyrimet afatgjata:</i>	
8% Obligacione (850 + 17 (L16 (vi)))	867
6% Notë krediti	160
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>	
Të pagueshmet tregtare (300 +101 - 2 (L16(v)))	<u>399</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>4,561</b>

**L11 Blerja e Margarita sh.a dhe Mimoza sh.a (emetimi i aksioneve nuk është regjistruara ende)**

	<b>Margarita (m)</b>	<b>Mimoza (m)</b>
Total kapitali aksionar (sipas PPF)	€250	€120
Numri i aksioneve (€0.50 secila)	500	240
Përqindja e blerë nga Melisa	80%	30%
Numri i blerë nga Melisa	400	72
Këmbimi i kontraktuar	3/5	2/3
Numri i aksioneve të Melisa i emetuar për konsideratën	240	48
Vlera e drejtë e aksioneve të emetuara për konsideratën (€3 secila)	€720	€144
Vlera nominale e aksioneve të zakonshme (€0.50 secila)	€120	€24
Slado tek llogaria e premisë së aksioneve	€600	€120

Hyrjet:

D Zëri i mirë 720

K Kapitali aksionar	120
K Premia e aksioneve	600

D Investimet në shoqëri 144

K Kapitali aksionar	24
K Premia e aksioneve	120

**L12 LLogaritja e zërit të mirë****€ milion**

Konsiderata

Aksione të zakonshme (L11: 240 x 3.00)	720
6% Notë krediti (500 aksione x 80% x 100/250)	<u>160</u>
	880
VD of IJK (500 aksione x 20% x €2.10)	210
VD e neto pasurive të blera	
Aksione të zakonshmes	250
Rezervat para blerjes	610
VDP - Stoqet	12
VDP - Toka	<u>(20)</u>
Zëri i mirë	<u>238</u>
Humbja nga dëmtimi	<u>(30)</u>
Saldo	<b>208</b>

**L13 Investimi në shoqëri**

Kosto e investimit (L11)	144
Shto: Pjesën e fitimeve pas blerjes (90 x 6/12 x 30%)	<u>13.5</u>
	<b>157.5</b>

**L14 Fitimet e mbajtura te grupit me 31 mars 2017**

	<b>Melisa</b>	<b>Margarita</b>	<b>Mimoza</b>
	<b>€m</b>	<b>€m</b>	<b>€m</b>
Saldo sipas PPF (total ne fund të vitit)	930	770	400
Minus saldo para blerjes (310 + (90 x 6/12))		(610)	(355)
Levizjet në VDP (stoqet) (L16 ii)		(12)	
FPR shitjen e fabrikës brenda grupit (L16 iii)	(17.5)		
FPR në shitjet e mallrave brenda grupit (L16 iv)		(6)	
Kosto shtesë e financimit në 8% obligacione (L16 vi)	<u>(17)</u>	—	—
Rezervat e korigjuara për konsolidim	895.5	142	45
Konsolido Margaritën (80% x 142)	113.6		
Konsolido Mimosën (30% x 45)	13.5		
Dëmtimi i zërit të mirë (80% x 30)	<u>(24)</u>		
<b>Totali i grupit</b>	<b>998.6</b>		

**L15 Interesi jo-kontrollues ne fund të vitit**

	<b>€m</b>
Saldo në blerje (vlera e drejtë)	210
Pjesa e rezervave pas blerjes (142 (L14) x 20%)	28.4
Pjesa e dëmtimit të zërit të mirë (20% x 30)	<u>(6)</u>
<b>Total</b>	<b>232.4</b>

**L16 Korigjimet**

Shënim (ii) Korigjimet e vlerës së drejtë:

	<b>Në blerje</b>	<b>Levizjet</b>	<b>Në datën e raportimit</b>
Toka	(20)	---	(20)
Stoqet	<u>12</u>	<u>(12)</u>	<u>0</u>
<b>Total</b>	<b>(8)</b>	<b>(12)</b>	<b>(20)</b>

Shënim (iii) Transferi i fabrikës brenda grupit

Fitimi i porealizuar në transfer (njohur nga Melisa)	20
Zhvlerësimi shtesë që duhet të eliminohet (1/4 x 20 x 6/12)	<u>(2.5)</u>
Korigjimet për të zvogëluar rezervat (Melisa) dhe PFP	17.5

Shënim (iv) Tregtimi i mallrave brenda grupit

Fitimi i porealizuar në mallrat e mbajtura në stoqet përfundimtare: €54m * 50/150 * 1/3 (shitur nga Margarita andaj IJK afektohet)	6
Korigjimet për të zvogëluar rezervën (Margarita) dhe stoqet	
Shënim (v) Saldo ndërgrupore	2
Korigjimet për të zvogëluar të pagueshmet dhe të arkëtueshmet	

Shënim (vi) 8% obligacionet

Kosto financiare për vitin duhet të jetë (850 x 10%)	85
Kosto financiare e njohur sipas notës (850 x 8%)	<u>68</u>
Shuma që mbetet për tu regjistruara	17
<i>Korrigjimet për të zvogëluar rezervat (Melisa) dhe rritur obligacionin</i>	

Shënim (viii) Dëmtimi i zërit të mirë

Shuma e dëmtimit është €30m. Kjo zvogëlon saldon e zërit të mirë. Pasi që zëri i mirë është llogaritur duke përdorur vlerën e plotë të drejtë, ngarkesa është ndarë ndërmjet prindit dhe IJK-së sipas proporcionit të ndarjës së fitimeve 80/20. Anda 24 i është ngarkuar rezervave të grupit dhe 6 IJK-së.

## **Problemi 2**

Ortensia sh.a bleu një makineri me kosto prej €220,000 me 1 janar 2013. Makineria është zhvlerësuar sipas modelit të koston së SNK 16 Prona, Fabrika dhe Paisjet në baza drejtvizore përgjatë pesë viteve duke supozuar zero vlerë të mbetur. Me 30 qershor 2016 makineria është klasifikuar si e mbajtur për shitje. Vlera e saj e drejtë është vlerësuar €80,000 dhe kosto për ta shitur €4,000. Me 31 dhjetor 2016, data raportuese, makineria nuk është shitur. Në atë datë vlera e drejtë është vlerësuar të jetë €62,000 dhe kosto e vlerësuar për ta shitur nuk kishte ndryshuar. Me 31 mars 2017, makineria ende nuk ishte shitur dhe ishte marrë vendim që të tërhiqet nga shitja, dhe që të zhvendoset makineria tek një pjesë tjetër e biznesit, ku pritet që të rikuperoj më shumë €58,000.

### **Kërkohet:**

**(i) Trego kriteret e SNRF 5 të cilat duhet të përmbushen me qëllim që një pasuri jo-qarkulluese të klasifikohet e e mbajtur për shitje. (5 pikë)**

**(ii) Llogariti shumat që duhet ti njoh Ortensia sh.a sa i përket kësaj makinerie në Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 dhe për tre muajt e përfunduar me 31 mars 2017 dhe në Pasqyrën e Pozitës Financiare në po të njejtat data.**

**(10 pikë)**

**(15 pikë)**

## Zgjidhja e Problemit 2

### 2.

(i) Një pasuri jo-qarkulluese është e klasifikuar si “e mbajtur për shitje” nëse vlera e saj bartëse do të rikuperohet kryesisht nga një transaksion i shitjes e jo nga përdorimi i vazhdueshëm. Që të jetë kështu, pasuria duhet të jetë në dispozicion për shitje të menjëhershme në kushtet e saja aktuale dhe shitja duhet të ketë shumë mundësi që të ndodhë. SNRF 5 liston kushtet të cilat duhet të përmbushen që një shitje konsiderohet si shumë e mundshme.

- Menaxhmenti është i zotuar ndaj një plani për ta shitur pasurinë dhe një program aktiv është inicuar për ta gjetur blerësin dhe përfunduar planin; dhe
- Pasuria është duke u vënë në treg në mënyrë aktive me një çmim që është i arsyeshëm në raport me vlerën e saj aktuale; dhe
- Pritet që shitja të përfundoj brenda një viti nga data e klasifikimit (mund të shtyhet nëse ndonjë vonesë shkaktohet nga rrethanat që janë jashtë kontrollit të entitetit); dhe
- Ka pak mundësi që do të ketë ndryshime të mëdha në plan ose që plani të tërhiqet.

Nëse këto kritere nuk përmbushen në fund të periudhës raportuese, pasuria nuk duhet të klasifikohet si e mbajtur për shitje. Nëse këto kritere përmbushen pas periudhës raportuese por pas autorizimit të pasqyrave financiare pëe publikim, fakti që tani pasuria është e klasifikuar si e mbajtur për shitje duhet të shpaloset në shënimet e pasqyrave financiare. **(5 pikë)**

### (ii)

	€
Kosto	220,000
Zhvlerësimi deri me 31 dhjetor 2015 ( $220,000 * 3/5$ )	<u>(132,000)</u>
Vlera bartëse me 1 janar 2016	88,000
Zhvlerësimi deri me 30 qershor 2016	<u>(22,000)</u>
Vlera bartëse me 30 qershor 2016	66,000

Pas klasifikimit si e mbajtur për shitje me 30 qershor 2016 vlera bartëse prej €66,000 krahasohet me vlerën e drejtë minus kosto për ta shitur €76,000 (80,000-4,000). Transferi tek pasuritë qarkulluese bëhet në vlerën më të ulët të këtyre dy shifrave, €66,000.

Me 31 dhjetor 2016, vlera e drejtë minus kosto e shitjes është rivlerësuar më €58,000 (62,000-4,000). Më e ulëta e vlerës bartëse në datën e transferit dhe vlera e drejtë minus kosto e shitjeve është tani €58,000. Si rrjedhojë, një humbje prej €8,000 njihet në fitim ose humbje për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 pasi vlera bartëse është zvogëluar nga 66,000 në €58,000.

Me 31 mars 2017, pasuria nuk kualifikohet më për klasifikim si “e mbajtur për shitje”. Andaj riklasifikohet tek pasuritë jo-qarkulluese. Vlera bartëse tani është më e ulëta e (i) vlerës së saj bartëse të mëhershme minus zhvlerësimi i mëpasëm (shuma që do të sihte ngarkuar sikur të mos kishte ndodhur Klasifikimi tek e “mbajtur për shitje”) dhe (ii) shumës së saj të rikuperueshme në datën e riklasifikimit.

Zhvlerësimi do të ngarkohet (në 2017) për të mbuluar periudhën prej 30 qershor 2016 deri 31 mars 2017. Kjo shumë është  $220,000 \times 1/5 \times 9/12 = €33,000$ . Andaj vlera bartëse tani është  $€66,000 - 33,000 = €33,000$ .

	<b>31 dhjetor 2016</b>	<b>31 mars 2017</b>
<b>PAGJ:</b>		
Zhvlerësimi i ngarkuar	(22,000)	(33,000)
Humbja në klasifikimin “e mbajtur për shitje”	(8,000)	
Anulim i humbjes në klasifikimin e “mbajtur për shitje”		8,000
<b>PPF:</b>		
Pasuritë qarkulluese: PjQ të mbajtura për shitje	58,000	
Pasuritë jo-qarkulluese – Prona, Fabrika & paisjet	33,000	

### Problemi 3

- a) SNK 37 Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente është një standard i rëndësishëm në rregullimin e njohës së detyrimeve dhe përdorimin e provizioneve. Ka qenë veçanërisht i dobishëm në kontrollin e abuzimeve të provizioneve për menaxhimin e fitimeve të raportuara.

**Kërkohet:**

**Përkufizo një provizion dhe sikuto në detaje tri kushtet që duhet të përmbushen që të njihet një provizion sipas SNK 37. Përgjigja e juaj duhet të shpjegoj se si kërkesat e SNK 47 janë konsistente me parimet që i përmban korniza konceptuale. (10 pikë)**

- b) Me 1 janar 2015, Erika sh.a vendosi të ndërtoj një ndërtesë të re. Ndërtimi ishte i financuar komplet nga një kredi prej €10 milion nga banka me një normë të interesit prej 9% në vit. Kredia ishte specifikisht e marrë për të financuar ndërtimin e ndërtesës. Ndërtesa e re do të përdoret si një pronë investuese.

Ndërtimi i ndërtesës filloi me 1 maj 2015 dhe është përfunduar me 1 shkurt 2017, por ishte e gatshme për përdorim si një pronë investuese me 1 mars 2017. Vlera e drejtë e ndërtesës ishte €15 milion me 1 mars 2017 dhe nuk kishte ndryshim të madh në vlerën e drejtë me 31 dhjetor 2017.

Është politikë e Erika sh.a që të kapitalizoj kostot e huamarrjes së shkaktuara në pajtim me SNK 23 Kostot e huamarrjes.

**Kërkohet:**

- i) **Bazuar në informatat e Erika sh.a, shpjego rrethanat kur kostot e huamarrjes mund të kapitalizohen në pajtim me SNK 23 Kostot e huamarrjes. (3 pikë)**
- ii) **Llogarite shumën totale të kostove të huamarrjes që mund të kapitalizohen si pjesë e kostos së ndërtesës. Trego shumën e kostos së financimit që duhet të shpenzohet në pasqyrën e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017. (4 pikë)**
- c) Violeta sh.a bleu një tokë me 1 janar 2013 për €6 milion. Është politikë e kompanisë të përdor modelin e rivlerësimit për tokën. Rivlerësimi kryhet në intervale 5 vjeçare. Me 31 dhjetor 2017, një vlerësues i pavarur e vlerësoi tokën në €8.5 milion. Bordi i drejtorëve vendosi që ta përfshijë këtë shumë në pasqyrën e pozitës financiare dhe ta dergoj diferencën në pasqyrën e të ardhurave.

**Kërkohet:**

**Shpjego shkurtimisht nëse veprimet e bordit të drejtorëve janë të duhura. (3 pikë)**

### Zgjidhja e Problemit 3

3. a)

*Përkufizimi i një provizioni*

Nje provizion është një detyrim për të cilin vlera monetare dhe koha se kur do të krijohet nuk është e sigurtë.

*Njohja*

Një provizion duhet të njihet vetem, dhe vetem kur:

- (a) entiteti ka një obligim aktual (ligjor apo të tërthortë si rezultat i ngjarjeve të kaluara;
- (b) ka shumë mundësi (më shumë po se sa jo) që do të ketë nevojë për një dalje të resurseve ekonomike për të shlyer detyrimin; dhe
- (c) shuma e obligimit mund të matet me besueshmëri.

Vlerësimi nese ka apo nuk ka obligim aktual mund të jetë problematik.

- Duhet të ketë një obligim aktual. Kjo nënkupton që nuk ka ndonjë rrugë tjetër të arsyeshme për të iu shmangur shlyerjes. Vetëm pse një pagesë do të ishte në interes të entitetit nuk është në vetvete një obligim i entitetit për ta bërë pagesen
- Obligim duhet të jetë rezultat i një ngjarje në të kaluaren, e quajtur ngjarje obliguese. Nëse obligimi varet nga një ngjarje në të ardhmen, nuk është obligim aktual.
- Që një obligim i tërthortë të kualifikohet si obligim aktual duhet të ketë prirje të vlefshme që entiteti do të përmbush obligimin dhe se entiteti ka për qëllim ta përmbush atë.
- Në raste të rralla nuk është e qartë nëse ka një obligim aktual. Në këto raste, një gjarje e kaluar konsiderohet që shkakton obligim aktual nëse, duke marrë për bazë të gjitha evidencat në dispozicion, ka me shumë gjasa sesa jo që një obligim aktual ekziston në datën e raportimit.

Dalja e përfitimeve ekonomike konsiderohet e mundshme nese ka më shumë gjasa të ndodh se sa të mos ndodhë. Kjo në përgjithësi nënkupton që është e mundshme më shumë se 50%. Vetëm pse një dalje ka gjasa nuk nënkupton që automatikisht ekziston një obligim. Gjithashtu duhet të ekzistoj ngjarja obliguese.

Standardi thekson që vetëm në raste shumë të rralla një vlerësim i besueshëm nuk do të kjetë i mundur.

Nëse ndonjë nga tri kushtet e mësipërme nuk përmbushet, atehere kemi një detyrim kontigjent, dhe shpalosja duhet të bëhet nëse është materiale.

*Konsistenca me Kornizen*

Pjesa kyqe e kornizës që ka të bëjë me provizionet është përkufizimi i detyrimit.

Ky përkufizim është si në vijim:

Obligim aktual që rrjedh nga ngjarjet e kaluara, shlyerja e të cilit pritet të rezultoj me dalje të resurseve jashtë entitetit.

Mund të shihet qartë që kushti i parë i vendosur në SNK 37 për njohjen e një provizioni është direkt i bazuar në përkufizimin e detyrimit në kornizë. Vlera e shtuar nga SNK 37 është mekanizmi për tu marrë me paqartësinë lidhur me shumën dhe kohen. SNK 37 gjithashtu jep

udhëzime substanciale të aplikimit të këtyre parimeve në rrethana specifike që dihet se shkaktojnë vështirësi.

Kushti i dytë dhe i tretë më lartë bazohen në kapitullin e “njohjës” të kornizës. Ky kapitull shpjegon që çdo element duhet të njihet kur (1) është e mundur që përfitimet ekonomike do të rrjedhin drejt/nga entiteti dhe (2) zëri ka një kosto apo vlerë që mund të matet me besueshmëri.

**b)**

i) Kur kostot e huamarrjes shkaktohen për një ‘pasuri të kualifikueshme’, mund të kapitalizohen si pjesë e kostos së asaj pasurie. Një pasuri e kualifikueshme është një pasuri e prekshme apo e paprekshme së cilës i duhet një periudhë e konsiderueshme kohore për të qenë gati për qëllimin e synuar apo për shitje eventuale. Andaj, kostot e huamarrjes duhet të kapitalizohen gjatë periudhës së ndërtimit.

Kapitalizimi duhet të filloj kur shpenzimi në pasuri ka ndoshtur. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që duhet të filloj nga data kur fondet janë huazuar. Kapitalizimi duhet të ndërpritet kur pasuria është gati për përdorimin e synuar, edhe pse fondet mundet që ende të shkaktojnë kosto të huamarrjes. Gjithashtu kapitalizimi duhet të pezullohet nëse ka pezullim të zhvillimit aktiv të pasurisë. Çdo kosto e huamarrjes që nuk është e pranueshme për kapitalizim duhet të shpenzohet. Çdo e ardhur nga investimi i përkohshëm i fondeve të huazuara veçanërisht duhet të zbriten nga shuma e kapitalizuar.

ii)

Total shuma e kostove të huamarrjes që duhet të kapitalizohet:

2015: €10 milion x 9% x 8/12 = €600,000

2016: €10 milion x 9% = €900,000

2017: €10 milion x 9% x 1/12 = €75,500

Total = €1,575,000

Pra, shuma që duhet të paraqitet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 = €825,000 (për 11 muaj) natyrisht nëse kredia mbetet e papaguar ende.

c) Sipas SNK 16, çdo tepricë e rivlerësimit sipas modelit të rivlerësimit duhet të dergohet tek teprica e rivlerësimit të pasurive dhe të paraqitet tek të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse. Veprimet e bordit të drejtorëve nuk janë të duhura pasi që nuk janë në pajtim me SNK 16. Teprica e rivlerësimit duhet të kreditohet tek fitimet e mbajtura vetem kur pasuria të shitet.

## Problemi 4

Jasmine sh.a është një kompani e listuar në bursë që monton artikuj elektrik vendor dhe i shet më pas të shitësit me shumicë dhe pakicë. Menaxhmenti i Jasmine sh.a oshte i dëshpëruar me rezultatet e kompanisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016. Në përjekje për të përmirësuar performancën masat në vijim janë marrë në fillim të vitit që përfundom me 31 dhjetor 2017:

- Një kampanjë nacionale e reklamimit ishte filluar,
- Zbritje për të gjithë kllientët me shumicë që blejnë mallra në sasi të mëdha të paracaktuara,
- Montimi i disa linjave u ndërpre dhe u zëvendësua me produkte të blera komplet të përfunduara. Kjo i lejoi Jasmine sh.a që të largoj fabrikën e tëpërt.

Pasqyrat e përmbledhura financiare të Jasmine sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 janë dhënë më poshtë:

### Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017

	€m
Të hyrat (25% në para të gatshme)	4,000
Kosto e shitjeve	<u>(3,450)</u>
Fitimi bruto	550
Shpenzimet operative	(370)
Fitimi operativ	180
Fitimi në heqjen e fabrikës (shënim (i))	40
Shpenzimet e interesit	<u>(20)</u>
Fitimi para tatimit	200
Shpenzimet e tatimit	<u>(50)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>150</b>

### Pasqyra e pozitës financiare me 31 dhjetor 2017

	€m	€m
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Pronat, fabrikat dhe paisjet (shënim (ii))		550
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Stoqet	250	
Të arkëtueshmet tregtare	360	
Banka	-	<u>610</u>
<b>Total pasuritë</b>		<b>1,160</b>
<i>Ekuiteti</i>		
Kapitali aksionar (400m aksione)	100	
Fitimet e mbajtura	<u>380</u>	
		480

<i>Detyrimet afatgjata:</i>		
8% notë krediti		200
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>		
Mbitërheqja bankare	10	
Të pagueshmet tregtare	430	
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>40</u>	<u>480</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>1,160</b>

Më poshtë janë koeficientët e llogaritur për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016:

Kthimi në kapitalin e angazhuar (fitimi para interesit dhe tatimit/total pasuritë minus detyrimet afatshkurtera)	28.1%
Qarkullimi i neto pasurive (kapitalit të angazhuar)	4 here
Marzha e fitimit bruto	17%
Marzha e fitimit neto (para tatimit)	6.3%
Koeficienti i qarkullimit	1.6:1
Periudha e qarkullimit të stoqeve (stoqet në fund)	46 ditë
Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme	45 ditë
Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme	55 ditë
Fitimi i dividendes	3.75%
Mbulesa e dividendës	2 here

#### **Shënim**

- Jasmine sh.a arkëtoi €120m nga shitja e fabrikës që kishte vlerë bartëse prej €80m në datën e shiitjes.
- Çmimi i tregut të aksioneve të Jasmine sh.a përgjatë vitit ishte mesatarisht €3.75 për aksion.
- Nuk ka pasuri emetim apo ripagim të akioneve apo notave të kreditit gjatë vitit.
- Dividendat e paguara gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2017 ishin €90m, që ishte shuma e njëjtë me dividendën e paguar në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016.

#### **Kërkohet:**

- Llogariti koeficientët për vitin e përfunduar me 31 dhjetor, 2017 (trego llogaritjet tuaja) për Jasmine sh.a, ekuivalente me ato të dhëna më sipër. (10 pikë)**
- Analizo performancën dhe pozitën financiare të Jasmine sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017 krahasuar me vitin paraprak. (10 pikë)**

## Zgjidhja e Problemit 4

### 4. a)

Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA)

Fitimi para interesit dhe tatimit/pasuritë minus detyrimet afatshkurtera  $220/680 \times 100 = 32.3\%$

Qarkullimi i neto pasurive = Të hyrat/Neto pasuritë =  $4,000/680 = 5.9$  here

Marzha e fitimit bruto = Fitimi bruto/Të hyrat =  $550/4,000 \times 100 = 13.8\%$

Marzha e fitimit neto = Fitimi para tatimit/Të hyrat =  $200/4,000 \times 100 = 5\%$

Koeficienti i qarkullimit = Pasuritë qarkulluese/Detyrimet afatshkurtera =  $610/480 = 1.27: 1$

Periudha e qarkullimit të stoqeve (stoqet në fund) =  
= Stoqet/Kosto e shitjeve =  $250/3,450 \times 365 = 26$  ditë

Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme =  
= Të arkëtueshmet tregtare / Shitjet me kredi  $\times 365 = 360/3,000 \times 365 = 44$  ditë

Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme =  
= Të pagueshmet tregtare / Blerjet me kredi  $\times 365 = 430/3,450 \times 365 = 45$  ditë

Fitimi i dividendes =  
= Dividenda për aksion/Çmimi i tregut për aksion  $\times 100 = 22.5/375 \times 100 = 6\%$   
\* Dividenda për aksion = Dividenda e paguar/Numri i aksioneve =  $90/400$

Mbulesa e dividendës = Neto fitimi pas tatimit/Dividenda e paguar =  $150/90 = 1.67$  here  
Fitimi për aksion/Dividenda për aksion

b) Analiza e krahasimit të performancës dhe pozitës financiare të Jasmine sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017.

Gjëja e parë që vihet re tek rezultatet e Jasmine sh.a është që KNKA është rritur për 4.2 pikë përqindje nga 28.1% në 32.3%. Në shikim të parë është shumë e mirë, por duhet marrë parasysh faktin që kapitali i angazhuar është zvogëluar pas shitjes së fabrikës dhe fitimi neto është rritur nga shitja e fabrikës. Pra KNKA është fryrë nga ky transaksion dhe duhet të shikojmë se si do të kishte qene KNKA pa shitjen e fabrikës. Duke e larguar shitjen e fabrikës na dalin këta koeficient:

$KNKA = 180 / (680 + 80) \times 100 = 23.7\%$

Qarkullimi i pasurive neto =  $4,000/760 = 5.3$  here

Marzha e fitimit neto =  $160/4,000 \times 100 = 4\%$

Duke krahasuar këta koeficientë me ata të periudhës së përfunduar me 31 dhjetor 2016 mund të shohim që KNKA ka rënë. Kjo rënie është rezultat i rëniës së marzhës së fitimit neto. Qarkullimi i pasurive është përmirësuar në krahasim me vitin e kaluar edhe pas shtimit të fabrikës.

Marzha e fitimit neto mund të analizohet në dy faktorë - marzhen e fitimit neto dhe nivelet e shpenzimeve. Përqindja e fitimit bruto është 3.2 pikë përqindje më e ulët se në vitin parapark. Kjo ka mesiguri se ka ndodhur për shkak të zbritjeve të ofruara për klientët me shumicë, gjë që do të rrisë shitjet në barrë të profitabilitetit. Zëvendësimi i disa linjave të prodhimit më artikuj të blerë mesiguri se ka zvogëluar marzhat e fitimit. Shitjet mund të jenë rritur nga kampanja e reklamimit, por kjo ka qenë edhe një shpenzim shtesë kundrejt fitimit neto. Me sa duket menaxhmenti ka shikur që të rrisë të hyrat në çdo mënyrë. Shitja e fabrikës ka shërbyer që të maskoj efektin në fitime..

Likuiditeti i Jasmine sh.a gjithashtu ka rënë gjatë vitit aktual. Koeficienti qarkullues ka rënë nga 1.6 në 1.3. Megjithatë, ka pasur një rënie të theksuar në peridhën e qarkullimit të stoqeve, mesiguri për shkak të mbajtjes së sasive më të vogla të lëndës së parë për prodhim. Mund të jetë që mallrat e përfunduara mund të dergohen direkt tek klientët me shumicë nga furnitori. Kjo i shërben rënies së koeficientit qarkullues. Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme ka mbetur konstante por periudha e pagesës së llogarive të pagueshme ka rënë për 10 ditë. Duket se, për shkak të dergasave të menjëhershme, furnitori i mallrave të gatshme kërkon pagesa të menjëhershme. Kjo rënie në periudhën e pagesës së llogarive të pagueshme do të duhet të ndihmonte koeficientin qarkullues. Nuk i kemi detajet e saldoeve të parave në vitin e kaluar, por Jasmine sh.a aktualisht nuk ka para në bankë dhe ka një mbitërheqje prej €10m. Pa €120m nga shitja e fabrikës situata e likuiditetit do të kishte qenë qartazi shume me e keqe.

Fitimi nga dividenda është rritur nga 3.75% në 6%, që është një gjë e mirë sa i përket investitorve potencial. Por na është thënë se dividenda totale është e njejtë më vitin e kaluar. Pasi që nuk ka pasur emetim të aksioneve, kjo nënkupton që dividend për aksion është e njejtë me vitin e kaluar. Pra, rritja në fitimin nga dividend nga mundur të ndodhë vetëm nga rënia e çmimit të aksioneve. Tregu nuk është i kënaqur me rezultatet e Jasmine sh.a. Në të njejtën kohë mbulesa e dividendës ka rënë. Pasi që është paguar dividend e njejtë, kjo nënkupton që ka pasur fitim më të ulët (mbulimi i dividendes i vitit të kaluar ishte 2.0, pra fitimi duhet të ketë qënë €180m). Menaxhmenti vendosi që ishte me rëndësi të mbahet niveli i njejtë i dividendes, por kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për ta mbajtur çmimin e aksioneve lartë.

Si përfundim, mund të themi që performance dhe pozita financiare e Jasmine sh.a ka rënë në krahasim me vitin e kaluar dhe çdo përmirësim i dukshëm është për shkak të shitjes së fabrikës.

## Problemi 5

a) Korniza konceptuale e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit përmban konceptet që përbëjnë bazën e pregaditjes dhe prezantimit të pasqyrave financiare për përdoruesit e jashtëm.

**Kërkohet:**

**Diskuto rëndësinë dhe kufizimet e mundshme të Kornizës Konceptuale për Raportim Financiar. (5 pikë)**

b) SNK 38 Pasuritë e paprekshme ka të bëjë me njohjen dhe matjen pasuese të pasurive të paprekshme.

**Kërkohet:**

i) Shpjego termin 'pasuri e paprekshme', dhe trego pasuritë e paprekshme që janë në fushëveprim të SNK 38 Pasuritë e paprekshme. (2 pikë)

ii) Shpjego katër (4) Kriteret që duhet të përmbushën përpara se një shpenzim të njihet si pasuri e paprekshme sipas SNK 38 Pasuritë e paprekshme. (3 pikë)

c) Xhiliola sh.a ka emetuar një notë krediti të konvertueshme prej €5,000,000 me 18% në vlerë nominale me 1 janar 2015 me interes të pagueshëm çdo vit në fund të vitit. Tre vite më vonë me 31 dhjetor 2017, nota e kreditit bëhet e konvertueshme në aksione të zakonshme në baza të €100 notë krediti për 50 aksione të ekuitetit ose mund të ripaguhet në vlerën nominale në para në opcion të mbajtësit të notës së kreditit. Kontabilisti financiar i Xhiliola sh.a ka vërejtur që përdorimi i notës së kreditit ka qënë i favorshëm ndaj notës së kreditit të pakonvertueshme pasi që kjo e fundit do të përmbante një normë të interesit prej 24% me qëllim që të bëhej atraktive për investitorët.

Vlera e tanishme e një €1 të pranueshme në fund të vitit, duke u bazuar në normat e skontimit prej 18% dhe 24% janë:

Viti	18%	24%
1	0.847	0.806
2	0.718	0.650
3	0.609	0.524

**Kërkohet:**

(i) Trego trajtimin në kontabilitet të notës së kreditit të konvertueshme në pasqyrën e të ardhurave të Xhiliola sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, 2016 dhe 2017; dhe pasqyrën e pozitës financiare me datë 31 dhjetor 2015, 2016 dhe 2017. (8 pikë)

(ii) Trego regjistrimet në ditar në fund të vitit 2014 duke supozuar që

(a) nota e kreditit konvertohet në aksione (1 pikë)

(b) nota e kreditit ripaguhet (1 pikë)

[Total: 20 pikë]

## Zgjidhja e Problemit 5

### 5. a)

#### i) Rëndësia e Kornizës Konceptuale për Raportim Financiar

- i) Korniza Konceptuale ka për qëllim të ndihmoj BNSK në zhvillimin e Standardeve të ardhshme Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe në rishikimin e atyre ekzistuese. Evitohet situara në të cilën standardet zhvillohen individualisht, kur njihet një problem në kontabilitet që është krijuar atehere resurset adresohen në standardizimin e kësaj praktike në kontabilitet, pa marrë parasysh nëse ajo çështje ishte domosdoshmërisht çështja më e rëndësishme që i takonte asaj kohe dhe që nuk ishte e standardizuar. Për më tepër, nëpërmjet Kornizës Konceptuale, ata të cilët janë të interesuar në punën e BNSK-së marrin më shumë informata në qasjen e BSNK-së në formulimin e SNRF-ve.
- ii) Edhe pse, Korniza Konceptuale i ndihmon standard-vënësit kombëtar në zhvillimin e standardeve, ka qëllim kryesor t'i ndihmoj Bordit në promovimin e harmonizimit të rregulloreve, standardeve të kontabilitetit dhe procedurat që kanë të bëjnë me prezantimin e pasqyrave financiare duke siguruar një bazë për zvogëlimin e trajtimeve alternative në kontabilitet të lejuar nga SNRF-të.
- iii) Gjatë përgaditjes dhe prezantimit të pasqyrave financiare, Korniza Konceptuale siguron një udhëzim për përgaditësit e pasqyrave financiare në aplikimin e SNRF-ve. Disa standarde koncentrohen në pasqyrën e të ardhurave ndërsa disa mund të koncentrohen në vlerësimin e pasurive neto (pasqyrën e pozitës financiare) por korniza konceptuale kujdeset për çdo aspekt të pasqyrave financiare. Dhe për auditorët të cilët duhet të pohojnë pamjen e drejtë dhe të sinqertë të pasqyrave financiare të përgaditura dhe të prezentuara, Korniza Konceptuale i ndihmon auditorët në formimin e një opinion nëse pasqyrat financiare janë në pajtim me SNRF-të.
- iv) Iu mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të interpretojnë informatat e përfshira në pasqyrat financiare të përgaditura në pajtim me SNRF-të. Kur ka një konflikt ndërmjet grupeve të përdoruesve se cila politikë të zgjedhet, politikat që rrjedhin nga Korniza Konceptuale do të jenë më pak të ekspozuara ndaj kritikave për standard-vënësit që bëhen për shkak të presionit të jashtëm.

#### ii) Kufizimet e Kornizës Koceptuale për Raportim Financiar

- i) Pasqyrat financiare janë për qëllim të një mori të përdoruesve dhe nuk është e qartë nëse një kornizë e vetme konceptuale mund të nxjerret që do të iu përshtatet të gjithë përdoruesve.
- ii) Duke pasur parasysh diversivitetin e kërkesave të përdoruesve, mund të ketë nevojë për një mori të standardeve të kontabilitetit, secili i krijuar për një qëllim ndryshe (dhe një koncept ndryshe si bazë).
- ii) Nuk është e qartë nëse korniza konceptuale e bën detyrën e përgaditjes dhe implementimit të standardeve më të lehtë se sa pa kornizen.

### b) Pasuritë e paprekshme

- i) Një pasuri e paprekshme është një pasuri jo-monetare pa substancë fizike. Pasuritë e paprekshme përbëhen nga shpenzimet në softuer kompjuterik , hulumtim dhe zhvillim, reklamim, brend etj. Përfshijnë gjithashtu të drejtat sipas marrëveshjes së licencimit për zëra të tillë si të drejtat e filmave, video inçizimeve, shfaqjeve, dorëshkrimeve, patentat dhe të drejtat autoriale. .
- ii) Kriteret e njohjes së një pasurie të paprekshme
- *Pasuria duhet të jetë e 'identifikueshme'*  
Një pasuri është e identifikueshme ose nëse është e ndashme (mund të shitet pa e shitur tërë biznesin) ose nëse rrjedh nga të drejtat kontraktuale apo ligjore, pa marrë parasysh mundësisë së ndarjes.
  - *Kontroll ndaj përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga pasuri*  
Kontrolli përfshin fuqinë për të marrë përfitimet ekonomike në të ardhmen që rrjedhin nga pasuria dhe të ndalojnë qasjen e të tjerëve në këto përfitime. Kapaciteti i një entiteti për të kontrolluar përfitimet ekonomike në të ardhmen zakonisht do të rezultoj, por jo domosdoshmërisht, nga të drejtat ligjore të cilat kanë të sanskionuara nga një gjykatë apo ligj.
  - *Përfitimet e ardhme ekonomike rrjedhin drejt entitetit*  
Këto përfitime mund të përfshijnë të ardhura nga shitja e produkteve dhe shërbimeve, por gjithashtu përfshijnë kursime të kostove dhe benefite tjera që rrjedhin nga përdorimi i pasurisë prej entitetit.
  - *Kostot mund të maten me besueshmëri*  
'Kosto' zakonisht do të jetë kosto e blerjes apo zhvillimit të pasurisë. Në rastin e një pasurie të blerë në një kombinim biznesi, 'kosto' do të jetë vlera e drejtë e pasurisë në datën e blerjes, duke supozuar që kjo vlerë e drejtë mund të matet me besueshmëri.
- c) Kjo pyetje ka të bëjë me një instrument financiar të përbërë (borxh i konvertueshëm). Trajtimi është në pajtim me SNK 39 Instrumentet financiare

i) eksatraktet e pasqyrave financiare

<i>Pasqyrat e të Ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015</i>	
Kosto financiare (shih llogaritjet)	1,056,480
<i>Pasqyrat e të Ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016</i>	
Kosto financiare (shih llogaritjet)	1,094,035.2
<i>Pasqyrat e të Ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2017</i>	
Kosto financiare (shih llogaritjet)	1,140,603.65
<i>Pasqyrat e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2015</i>	
Detyrimet afatgjata	
18% notë krediti e konvertueshme (4,402,000 + 1,056,480 – 900,000)	4,558,480
Ekuitet (Opcioni për konvertim) [5,000,000 – 4,402,000]	598,000
<i>Pasqyrat e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2016</i>	
Detyrimet afatgjata	
18% notë krediti e konvertueshme (4,558,480 + 1,094,035.2 – 900,000)	4,752,515.2

*Pasqyrat e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2017*

Detyrimet afatgjata

18% notë krediti e konvertueshme (4,752,515.2+ 1,140,603.65 – 900,000) 4,993,118.85

**Llogaritjet**

Përcaktimi i komponentes së borxhit dhe ekuitetit të instrumentit financiar të përbërë

Zëri	Rrjedhat e parasë €'000	Faktori skontues @ 24%	Vlera e tanishme €'000
Viti 1 interesi	18% x 5,000 = 900	0.806	725.4
Viti 2 interesi	18% x 5,000 = 900	0.650	585
Viti 3 interesi	18% x 5,000 = 900	0.524	471.6
Viti 3 Kryegjeja	5,000	0.524	2,620
Total vlera e komponentes së borxhit (vlera bartëse)			4,402
Arkëtimi nga emetimi			<u>5,000</u>
Komponenta e ekuitetit (vlera mbetese)			598

Shënim: Kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave për vitin 2015, për shembull, është llogaritur si €4, 402,000 x 24% = €1, 056,480. Në të njejtën kohë, interesi që do të paguhet është €5, 000,000 x 18% = €900, 000. Kjo kërkon një akruale prej €156, 480 (që është, €1, 056,480 – 900,000). Kjo akruale duhet të shohet tek vlera bartëse e borxhit për të arritur tek kostoja e amortizuar në fund të vitit 2015.

Plani i amortizimit të kredisë

Viti	Detyrimi në fillim	Ngarkesa financiare @ 24%	Interesi i paguar @ 18% ose kryegjeja e paguar ose konvertim në aksione	Detyrimi në fund
1	4,402,000	1,056,480	(900,000)	4,558,480
2	4,558,480	1,094,035.2	(900,000)	4,752,515.2
3	4,752,515.2	1,140,603.65	(900,000)	4,993,118.85
4	4,993,118.85*	-	(5,000,000)	-

\* Diferenca për shkak të rrumbullakësimit

*a) nëse konvertohet në aksione*

D Detyrim financiar	5,000,000	
D Ekuitet (Opcioni për konvertim)	598,000	
K Ekuitet –kapitali aksionar		5,000,000
K Ekuitet (premia e aksioneve)		598,000
<i>Nëse ripaguhet</i>		
D Detyrim financiar	5,000,000	
K Para		5,000,000

